



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.16, datë 16.11.2023

Për

**“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT: “ANALIZË E
TREGJEVE ME SHUMICË TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETET E
TELEFONISË SË LËVIZSHME (CELULARE)””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtare
Z.	Armer	Juka	Anëtar
Z.	Bleron	Dokle	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 16.11.2023, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit – “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)””.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 31 e në vijim i Kreut VI, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (*Ligji nr. 9918/2008*);

2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);
3. Rregullore nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, datë 17.7.2009, e ndryshuar;
4. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”;
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumenti i analizës së tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, është përgatitur në zbatim të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe merr në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian, me synimin përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e telefonisë së lëvizshme në Republikën e Shqipërisë.
2. Ky dokument:
 - a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë të të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - b. nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918/2008 dhe Rregulloren për Analizën e Tregut 9/2009;
 - c. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut në Shqipëri;
 - e. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.

3. Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme janë pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me nr. 9, datë 17.7.2009 “Për Analizën e Tregut”, e ndryshuar, gjithashtu edhe pjesë e tregjeve për rregullim sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian të vitit 2007 dhe vitit 2014, dhe për këtë arsye AKEP nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të tre kritereve nëse këto janë tregje përkatës të justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante*.
4. Bazuar në Rregulloren nr. 9, datë 17.7.2009 “Për Analizën e Tregut”, AKEP analizon për FNT tregjet përkatës të mëposhtëm si tregje të mundshëm për ndërhyrje *ex-ante* në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike, *inter alias*:
 - Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet publike të telefonisë së lëvizshme.
5. Pas perfundimit të Këshillimit Publik të dokumentit me palët e interesuara, AKEP vijon me vendimmarrjen për miratimin e dokumentit përfundimtar, si edhe miratimin e vendimeve individuale për sipërmarrësit e përcaktuar me fuqi të ndjeshme dhe vendosjen e masave rregullatore në tregjet e shumicës të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit “*Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet publike të telefonisë së lëvizshme (celulare)*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e Këshillimit Publik të kryhet për një periudhë 60 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për Këshillim Publik “*Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)*”, të publikohen në faqen e internetit akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Armer Juka	Bleron Dokle